



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKES
THE MUNICIPALITY SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

05 NR. 244

Datë : 07.07.2026

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversital në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, :Ligjin për Arsim dhe aftësim profesional nr.04L-138 ,dhe bazuar në Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Gjimnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP), të caktuara nga MASHT, Drejtoria komunale e Arsimit-Suharekë shpall

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2026/2027

1.Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe IAAP në vitin shkollor 2026/27, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2.Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- **Fletëparaqitjen** (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- **Dëftesën** origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- **Ekstraktin e lindjes.**

3.Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2026/2027, bëhet më datën 07.08, dhe 09 korrik 2026, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 9:00-16:00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 10.07.2026.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 11.07.2026.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimi të përgjigjes nga shkolla.

A.Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar(40%) 40 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar(20%) 20 pikë
3. Numri i pikëve nga testi(40%) 40 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA –SUHAREKË



Plani i regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë në Gjimnaz dhe Institucionet e Arsimit dhe Aftësimi
Profesional (IAAP) për vitin shkollor 2026/2027

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT -SUHAREKË

Komuna	Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.
Suharekë	"Skënder Luarasi"	Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Teknik i Sistemeve të TIK-ut	1	24
			Teknik i Informatikës së Biznesit	1	24
		Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Instalues elektrik	1	24
			Instalues i ngrohjes e klimatizimit dhe ujësjellësit ("INKU")	2	48
			Automekanik	1	24
			Metalpunues	1	24
			Ndërtimtari	1	24
			Arkitekturë	1	24
		Art	Dizaj i tekstilit dhe veshjeve	1	24
			Gjithsej: Skender Luarasi	10	240
Komuna	Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr. i paralele	Nr. i nxënësve
Suhareke (Shirokë)	IAAP "Abdyl Ramaj"	Ekonomi, Administrim dhe Juridik	Kontabiliteti	1	20
			Marketing	1	20
			Tregtia me shumicë dhe pakicë (A. Dual)	1	20
			Asistent Juridik	1	20
		Shërbime (Hoteleri-Turizem)	Kuzhinier - (Arsim Dual)	1	20
		Makineri, prodhim dhe ndërtimtari (Kimi-Teknologji)	Zdrukhëtar - (Arsim Dual)	1	20
			Galanteria e lëkurë punimit të këpucëve	1	20
			Laborant i kimisë	1	20
		Agrokulturë, pylltari, peshkatari dhe veterinari	Teknologjia ushqimore	1	20
			Hortikulturë	1	20
GJITHSEJT				10	200

Suharekë (Shirokë)	IAAP "Abdyl Ramaj"	Shëndeti dhe mirëqenia	Bashkëpunëtor profesional i infirmierisë	1	24
			Teknik dentar	1	24
GJITHSEJT				2	48
Gjithsej				12	248

Suharekë	Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr. i paralel.	Nr. i nxënës.
	Gjimnazi "Jeta e re"	Dy drejtimor	shkenca natyrore	4	88
			shkenca shoqërore	2	44
			Gjithsej Gjimnazi	6	132

Drejtori i Drejtorisë komunale të Arsimit-Suharekë
Remzi Bajselmani

